



Komuna Vushtrri

KRM.Uniteti – Mitrovicë

Bazuar në nenin 17, pika (f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15, nenin 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, me datën \_\_\_\_\_ 2024 arrihet kjo:

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI  
PËR BARTJEN E OBJEKTEVE TE KRM “UNITETI”-MITROVICË-NJËSIA VUSHTRRI, NË  
SHFRYTËZIM TË PËRHERSHËM NË KOMUNËN E VUSHTRRIË**

**Palët e marrëveshjes:**

Komuna e Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson **z.Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme komuna).

KRM “Uniteti”, në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson **z.Gazmend Morina**, Kryeshef Ekzekutiv (në tekstin e mëtejme “Uniteti”).

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është bartja në shfrytëzim të përhershëm me kompensim të objekteve të paluajtshme të KRM “Uniteti”, në Mitrovicë, njësia në Vushtrri, komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2  
Objekt i marrëveshjes**

Objekt i marrëveshjes janë objektet e ndërtuara rreth viteve 1970, në shfrytëzim të KRM “Uniteti” – Mitrovicë – njësia në Vushtrri duke u bazuar në raportin e komisionit profesional për vlerësim financiar, me nr. 2185/24 i datës 12.01.2024.

**Neni 3  
Obligimet dhe përgjegjësitë e palëve**

**3.1 KRM “Uniteti” Mitrovicë,**

3.1.1 KRM “Uniteti”, në Mitrovicë, merr për obligim që objektet e paluajtshme të cekur në nenin 2 të kësaj marrëveshje t’i bartë Komunës së Vushtrrisë.

3.1.2 Objektet që janë lëndë e kësaj marrëveshje, janë: objekte: (depo, garazha, zyre) të cilat janë të përkshuara në raportin e komisionit profesional si: objekti 1A, 1B, 1C, 1D, 1E, duke dhënë vlerësimin në euro për secilin objekt. Vlera e përgjithshme monetare për të gjitha objektet është 10,782.00 € (dhjetëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy euro).

3.1. Bartja në shfrytëzim të objekteve të cekura në nënparagrafin paraprak bëhet në ditën e nesërme nga dita e konfirmimit të kryerjes së pagesës nga komuna, me anë të procesverbalit për dorëzim – pranim.



### 3.2 Komuna e Vushtrrisë,

3.2.1 Merr për obligim që të kryej pagesën në shumën e cekur në nënparagrafin 3.1.2 të këtij neni, për pronën e bartur, duke u bazuar në raportin e komisionit profesional të themeluar me përfaqësues të KRM "Uniteti" dhe zyrtar të komunës.

3.2.2 Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe kryerjen e pagesës, Komuna e Vushtrrisë fiton të drejtën e hyrjes në posedim dhe shfrytëzimin e objekteve.

#### Neni 4.

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Ne rast të mosmarrëveshjeve midis tyre, palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur, do t'i drejtohen gjykatës kompetente.

#### Neni 5

#### Zbatimi i kontratës

5.1 Ngarkohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Thesar të bëjnë zbatimin e kësaj marrëveshje.

5.2 Bashkëlidhur në këtë marrëveshje do të jetë: Raporti i komisionit për vlerësimin e pronës së paluajtshme që është objekt i kësaj kontrate dhe fletë dëshmia e pagesave të tatimit në pronë nga KRM "Uniteti".

#### Neni 6

#### Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre (3) ekzemplar identik në origjinal, prej të cilëve dy (2) për komunën dhe një (1) për KRM "Uniteti" Mitrovicë.

#### Neni 7

#### Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje të hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

  
Komuna e Vushtrrisë  
  
z. Ferit Idrizi,  
Kryetar

KRM "Uniteti" Mitrovicë

  
z. Gazmend Morina,  
Kryeshef Ekzekutiv